



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 9 mars 2023, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, (AMA) u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “STAR NEWS-RTV” sh.p.k. për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv “TV Star Plus”, në allotmentin Lezhë (**Vendimi nr. 8 , datë 09.03.2023**).
2. Rrëzimin e aplikimit të shoqërisë “Albanian Media” sh.p.k., me NIPT: L91303013I, për marrje autorizimi për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, online mbështetur në rrjet IP (OTT) “Info 24”, për shkak të mangësive të konstatuara në dokumentacion (**Vendimi nr. 9 , datë 09.03.2023**).
3. Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Adriatik Bajrami, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV Kabllor Delvina”, për reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit nga zona “*Njësia administrative Delvinë dhe Bashkia Finiq*” në “*Njësitë administrative Delvinë dhe Finiq*” (**Vendimi nr. 10, datë 09.03.2023**).
4. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Tv Kabllor Vlora Cable” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV Kabllor Vlora Cable”, për reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit, duke hequr dorë nga “*Njësia administrative Himarë*” (**Vendimi nr. 11, datë 09.03.2023**).
5. Pranimin e kërkesës për reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Gentian Biçiku, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV Kabllor M&G”, duke hequr dorë nga zona e ofrimit “*Njësia administrative Tregan*” (**Vendimi nr. 12, datë 09.03.2023**).

6. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “MRM” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “TV LOBI” (**Vendimi nr. 13 , datë 09.03.2023**).
7. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Abc News” sh.a., licencuar për subjektin audioviziv privat “ABC NEWS” dhe për subjektin audio “ABC NEWS”, për ndryshimin e logos së transmetimit (**Vendimi nr. 14 , datë 09.03.2023**).
8. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Radio Ime” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Ime”, me zonë ofrimi shërbimi “*Bashkitë Tiranë, Durrës, Kamëz, Shijak, Vorë*” (**Vendimi nr. 15 , datë 09.03.2023**).
9. Rinovimin e licencës së shoqërisë “DYNAMICSOUND” sh.p.k., për subjektin audio privat rajonal “Radio One” dhe pranimin e disa prej kërkesave të subjektit për ndryshime të kushteve teknike të licencës (**Vendimi nr. 16, datë 09.03.2023**).
10. Ndryshimin e formës së organizimit të subjektit tregtar nga person fizik Shkëlqim Hajno, në shoqërinë “RADIO SARANDA” sh.p.k., rinovimin e licencës së subjektit audio privat “Radio Saranda” dhe ndryshimin e zonës së licencimit nga “*Bashkia Sarandë*” në “*Bashkia Sarandë, Njësitë administrative Aliko, Finiq dhe Mesopotam*” (**Vendimi nr. 17 , datë 09.03.2023**).
11. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “ONE ALBANIA” sh.a., autorizuar për ofrimin dhe përsëritjen e shërbimeve të programit audioviziv, online mbështetur në rrjet (IPTV), (OTT) dhe “Info Channel”, për ndryshimin e emrit të subjektit tregtar nga shoqëria “One Telecommunications” në “ONE ALBANIA” (**Vendimi nr. 18 , datë 09.03.2023**).
12. Shtyrjen e shqyrtimit të ankimit administrativ të shoqërisë “Tibo” sh.p.k., për subjektin OSHMA “Tibo”, lidhur me vendimin nr. 14 datë 29.09.2022 për dënimin me gjobë, në masën 2 000 000 (dy milion) lekë, për mbledhjen e ardhshme të AMA-s.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 9 mars 2023